



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1358 Prot.

Tiranë, më 06 . 12 .2021

UDHËZIM

Nr. 1 , datë 06 . 12 .2021

PËR
HARTIMIN, BASHKËRENDIMIN, MIRATIMIN DHE KONTROLLIN E PROCESIT TË
RISHIKIMIT TË DOKUMENTEVE TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE ME
PROCEDURË TË THJESHTUAR

Në mbështetje të nenit 28, të Ligjit Nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, neneve 3, 9, 13, 25, dhe 26, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”,

UDHËZOJ:

1. Ndërmarrjen e nismës për rishikimin e dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar, vetëm për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
 - a. Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore;
 - b. Janë në përputhje, nuk bien në kundërshtim dhe nuk ndryshojnë dokumentin e Strategjisë Territoriale;
 - c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mospërputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;
 - d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale, si edhe
 - e. Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
2. Rastet për të cilat aplikohet Procedura e Thjeshtuar e Rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore, por pa u kufizuar në to janë si më poshtë:
 - a. Përshtatja e kushteve të zhvillimit me gjendjen faktike në territor; përfshirë lejet e ndërtimit të lëshuara para miratimit të dokumentit të PPV-së dhe objekte të ndërtuara, të cilat nuk janë të përfshirë në dokumentin e PPV-së së miratuar.
 - b. Korrigjime të lapsuseve apo gabimeve të mundshme gjatë hartimit të dokumentit të PPV-së (raste të tilla të trajtuara veçmas mund të ndjekin edhe procedurën e korrigjimit);

- c. Ndryshime të kategorive/ nënkategorive/ funksioneve, kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, raportit në % mes (nën) kategorive të përdorimit të tokës, brenda të njëjtit sistem territorial;
 - d. Përputhje të përcaktimeve në Pasaportat dhe Hartat (Rregullore, Plan Zhvillimi), të cilat kanë mospërputhje me njëra-tjetrën (raste të tilla të trajtuara veçmas mund të ndjekin edhe procedurën e korigjimit);
 - e. Heqja e kushtit të hartimit të dokumentit të Planit të Detajuar Vendor, për ato njësi për të cilat është konstatuar si kusht i panevojshëm, gjatë implementimit të dokumentit të PPV-së;
 - f. Ndryshim të kufijve të Njësive Strukturore apo kushteve të zhvillimit (nr. katesh, lartësi, KSHT, intensitet ndërtimi, etj), në rastet kur argumentohet se, kushtet e vendosura vështirësojnë zbatimin e dokumentit të PPV;
 - g. Ndryshime ose shtesa në nene/ përcaktime të Rregullores, Planit të Zhvillimit të Territorit dhe/ ose shtojcave përkatëse, të cilat lehtësojnë zbatimin e dokumentit të PPV, por nuk ndikojnë në mënyrë thelbësore në përmbajtjen e tij;
 - h. Ndryshime ose shtesa në nene/ përcaktime të Rregullores me qëllim integrimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave apo Këshillit Kombëtar të Territorit;
 - i. Ndryshime të rrjeteve të infrastrukturës rrugor dhe hekurudhore duke përshtatur gjurmën, kategorinë, etj, me gjendjen faktike, projekte të miratuara nga ente publike me përgjegjësi në fushën e infrastrukturave të transportit dhe sipas legjislacionit sektorial në fuqi.
3. Procedura e Thjeshtuar e Rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore përmban hapat si më poshtë:
 - a. Ndërmarrja e Nismës për rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor;
 - b. Hartimi i dokumentit të ndryshimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor;
 - c. Procesi i bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike;
 - d. Procesi i miratimit të dokumentit të rishikuar të Planit të Përgjithshëm Vendor.
 4. Pjesë integrale e këtij Udhëzimi është Shtojca I, ku përcaktohet në mënyrë të detajuar procedura për rishikimin e dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore, referuar pikës 3 të këtij Udhëzimi.
 5. Ngarkohen Autoritetet Vendore, të cilat ndërmarrin nismën për rishikimin e dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.
 6. Ngarkohen Autoritetet Vendore të bashkërendojnë punën me AKPT, gjatë procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar.
 7. Ngarkohen Autoritetet Vendore të botojnë në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të gjitha dokumentat e prodhuara gjatë procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar.
 8. Shfuqizimin e Udhëzimit Nr. 01, datë 22.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar”

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Adelina GRECA



SHTOJCA I

Procedura e Thjeshtuar e Rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore

1. Marrja e Vendimit për ndërmarrjen e Nismës për rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor
 - a. Autoriteti përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit (Kryetari i Bashkisë) merr vendimin për ndërmarrjen e Nismës për rishikimin e dokumentit të PPV-së.
 - b. Vendimi përmban ndër të tjera:
 - i. Bazën ligjore ku mbështetet vendimi për ndërmarrjen e Nismës për rishikim/ndryshim të dokumentit të PPV-së;
 - ii. Shkaqet që sjellin nevojën për rishikimin/ndryshimin e përcaktimeve të PPV-së për njësinë/njësitë strukturore në fjalë;
 - iii. Cilësimin e dokumenteve apo pjesëve përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;
 - c. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë, për ndërmarrjen e nismës, botohet në RKPT, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së nismës.
2. Kryetari i Bashkisë me Urdhër ngre grupin e punës për rishikimin e PPV-së
 - a. Pjesë përbërëse e grupit të punës duhet të jenë të paktën specialistë të këtyre fushave:
 - i. të planifikimit të territorit;
 - ii. të informacionit gjeohapësinor;
 - iii. të mjedisit;
 - iv. të fushës juridike, të specializuar në çështje të planifikimit të territorit.
3. Hartimi i dokumentit të Nismës për rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor
 - a. Projekt Dokumenti i nismës për rishikimin e PPV-së përmban:
 - i. *qëllimin dhe nevojën e rishikimit të PPV-së;*
 - ii. *dokumentet apo pjesët përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;*
 - iii. *ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit të PPV-së;*
 - iv. *përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike duke specifikuar afatet;*
 - v. *planin e veprimeve për rishikimin e dokumentit të PPV-së;*
 - vi. *sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi, sipas nenit 33 të Ligjit Nr. 107/2014, shoqëruar me hartën përkatëse.*
 - b. Gjatë hartimit të projektdokumentit të nismës Autoriteti Vendor këshillohet në mënyrë të vazhdueshme me AKPT, nëpërmjet postës zyrtare dhe elektronike, takimeve dhe në çdo rast nëpërmjet Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).
 - c. Autoriteti vendor i Planifikimit boton dokumentin përfundimtar të Nismës në RKPT (të firmosur nga Kryetari i Bashkisë dhe të vulosur me vulën e Bashkisë) me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, dhe informon publikun mbi ndërmarrjen e nismës për rishikimin e dokumentit të PPV-së, nëpërmjet mjeteve tradicionale të informimit.
4. Hartimi i dokumentit të rishikuar të Planit të Përgjithshëm Vendor



- a. Autoriteti vendor përgatit Relacionin me propozimet konkrete për rishikimin e dokumentit të PPV-së sipas pjesëve përkatëse që preken nga Rishikimi. Ky Relacion këshillohet në mënyrë të vazhdueshme me AKPT, nëpërmjet postës zyrtare dhe elektronike, takimeve dhe në çdo rast nëpërmjet Regjistrisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (RKPT), sa herë që ndryshojnë propozimet për rishikim.
- b. AKPT, pas njohjes me ndryshimet e propozuara bën shqyrtimin dhe kontrollin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe atij sektorial. Për të lehtësuar procesin e shqyrtimit dhe kontrollit AKPT klasifikon/ kategorizon ndryshimet e propozuara nga Bashkia, sipas tipologjisë së ndryshimit të kërkuar, si më poshtë:
- i. *Objekte e ndërtuara nuk figurojnë në PPV;*
 - ii. *Nuk janë reflektuar lejet e dhëna (në fuqi);*
 - iii. *Kushte të zhvillimit nuk reflektojnë gjendjen faktike;*
 - iv. *Lapsuse (emra, kode në plan dhe rregullore);*
 - v. *Mospërputhje midis pasaportave;*
 - vi. *Kërkesa për zhvillim në njësi ku PPV nuk parashikon zhvillim (njësi ku Plani parashikon konservim, mbrojtje e tokës, etj të ngjashme);*
 - vii. *Kërkesat për ndryshim të kushteve të zhvillimit (nr. katesh, lartësi në metra, KSHT, Intensitet, etj);*
 - viii. *Kërkesa për ndryshim të kategorisë, nënkategorisë, funksionit, kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, raportit në % mes (nën)kategorive;*
 - ix. *Hegja e kushtit të PDV-së;*
 - x. *Ndryshim i kufijve të njësive strukturore (ndryshim sipërfaqe, ndryshim në nenet e rregullores, modifikime, shtesa);*
 - xi. *Ndryshime të hartës së fragmentimit të tokës (për PPV e hartuara me asistencën teknike të PLGP).*
 - xii. *Ndryshime të rrjetit rrugor, (kategoria, gjurma);*
 - xiii. *Saktësimi i kufirit administrativ;*
 - xiv. *Ndryshime të kufijve të njësive strukturore si rrjedhojë e saktësimit të kufirit administrativ..*
- c. Pas përfundimit të procesit të klasifikimit/kategorizimit, AKPT përgatit Draft-Dokumentin e Rishikimit të PPV-së, duke bërë paralelisht vlerësimin e rasteve në këtë dokument.
- d. AKPT përgatit Raportin Paraprak të Vlerësimit të propozimeve për ndryshime të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe bën me dije autoritetin vendor mbi vlerësimin e kryer sipas formës së përcjelljes/komunikimit së propozimeve për ndryshim nga Bashkia (postë zyrtare ose elektromike) dhe e boton atë në RKPT.
- e. Dokumenti i rishikuar i PPV-së, do të përmbajë ndryshimet e propozimeve të përcaktuara qartë, të cilat janë:
- i. *Ndryshime në nene apo pjesë përbërëse të Rregullores së Planit, Planit të Zhvillimit, Tabelës së Treguesve të Zhvillimit (Pasaportat);*
 - ii. *Ndryshime të kufijve të njësive strukturore si rrjedhojë e propozimeve për ndryshim dhe përshtatje të tyre sipas hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të Republikës së Shqipërisë;*
 - iii. *Reflektimi i propozimeve për ndryshime në formatin: *shapefile dhe atributet plotësuara*, në përputhje me Data Model GIS të përcaktuar nga AKPT.*
 - iv. *Shtojcat, në varësi të propozimeve për ndryshim.*



5. Bashkërendimi, këshillimi dhe takimet publike

- a. Procesi i bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike realizohet, sipas përcaktimeve të dokumentit të nismës të vendosura në bashkëpunim me AKPT-në.
- b. Për informimin e publikut, autoriteti vendor organizon të paktën 1 (një) dëgjese publike për rastet e propozuara për rishikim. Njoftimi kryhet përmes botimit nga autoriteti vendor në RKPT dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit publik, duke respektuar afatin e shkurtuar të njoftimit dhe në çdo rast jo më pak se 10 ditë përpara organizimit të dëgjesës publike;
- c. Dokumenti i rishikuar i PPV-së, vihet në dispozicion të publikut nga autoriteti vendor 10 ditë para ditës së organizimit të dëgjesës publike;
- d. Në përfundim të dëgjesës/takimit publik, grupi i punës në bashki përgatit raportin me përmbledhjet e vërejtjeve dhe/apo propozimeve të shprehura gjatë dëgjesës publike dhe e boton atë në RKPT, duke respektuar afatin ligjor për botimet.
- e. AKPT kryen procesin e bashkërendimit nëpërmjet organizimit të një takimi të Forumit të Bashkërendimit të Planifikimit në nivel Vendor (FBPV) ose në formë shkresore, duke identifikuar çështjet apo propozime për ndryshim të PPV, për të cilat nevojitet bashkërendimi sipas fushës përkatëse të përgjegjesisë shtetërore duke mbajtur për dijeni dhe autoritetin vendor. Korrespondencat shkresore të mbajtura në kuadër të procesit të bashkërendimit botohen në RKPT.
- f. Dokumenti përfundimtar me reflektimet e procesit të bashkërendimit të Rishikimit të PPV-së i dërgohet për njohje dhe konfirmim autoritetit vendor dhe botohet nga AKPT në RKPT, duke respektuar afatin ligjor për botimet.
- g. AKPT bashkërendon edhe me publikun e gjerë, nëpërmjet komunikimeve zyrtare që mbërrijnë në adresë të AKPT-së si me postë zyrtare ashtu edhe elektronike. AKPT vlerëson rastet dhe komunikon me autoritetin vendor për njohje dhe konfirmim nëpërmjet botimit në RKPT.
- h. Autoriteti Vendor i njofton Ministrinë përgjegjëse për Mjedisin, dokumentin e Rishikimit të PPV dhe merr qendrimin e saj nëse:
 - i) është i nevojshëm realizimi i procesit të VSM-së. Në këtë rast bashkia duhet të vijojë me ndjekjen e procedurës përkatëse;
 - ii) nuk ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të VSM-së.Në këto komunikime zyrtare mbahet për dijeni dhe AKPT.
- i. Kryetari i Bashkisë, pas njohjes dhe konfirmimit të Dokumentit të Rishikimit, bën kërkesë zyrtare/formale në AKPT për pajisje me Aktin e Përputhshmërisë për dokumentin e rishikimit të PPV-së, duke përcjellë në AKPT dhe botuar në RKPT, dokumentet si më poshtë:
 - i) Kërkesë AKPT për pajisje me Aktin e Përputhshmërisë;
 - ii) Vendimi i Kryetarit të Bashkisë për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e dokumentit të PPV-së, shoqëruar me dokumentin e Nismës së miratuar (nuk ka nevojë për ribotim, nëse dokumenti është i botuar dhe nuk ka pësuar ndryshime);
 - iii) Dokumenti i Rishikimit të PPV-së,
- j. AKPT përgatit Raportin e Vlerësimit Teknik për Dokumentin e Rishikimit dhe lëshon Aktin e Përputhshmërisë, duke respektuar afatin e shkurtuar të procesit të bashkërendimit dhe boton këto dokumenta në RKPT.

6. Miratimi i dokumentit të rishikuar të Planit të Përgjithshëm Vendor

- a. Kryetari i Bashkisë me kërkesë zyrtare dërgon për miratim në Këshillin Bashkiak dokumentin e rishikuar të PPV-së, i cili përmban:



- i. *Vendimin e Kryetarit të Bashkisë për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e dokumentit të PPV-së, shoqëruar me dokumentin e Nismës së miratuar;*
 - ii. *Dokumenti i Rishikimit të PPV-së;*
 - iii. *Aktin e Përputhshmërisë lëshuar nga AKPT ose Deklarata e Përputhshmërisë në heshtje;*
 - iv. *Vlerësimi Strategjik Mjedisor, si dhe deklarata mjedisore, në rast se është vlerësuar si e nevojshme nga Ministria përgjegjëse për mjedisin;*
- b. Pas miratimit të dokumentit të rishikuar të PPV-së në Këshillin Bashkiak, merret konfirmimi nga Prefekti dhe botohet në RKPT;
- c. Vendimi i miratimit të dokumentit të rishikuar të PPV-së nga Këshilli Bashkiak, botohet në RKPT, duke respektuar afatin ligjor për botimet.
- d. Kryetari i Bashkisë me kërkesë zyrtare dërgon për miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit dokumentin e rishikuar të PPV-së, i cili përmban:
- i. *Kërkesa e kryetarit të bashkisë për miratimin e Rishikimit të PPV-së në Këshill Bashkiak;*
 - ii. *Vendimin e Kryetarit të Bashkisë për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e dokumentit të PPV-së, shoqëruar me dokumentin e Nismës së miratuar;*
 - iii. *Dokumenti i Rishikimit të PPV-së,*
 - iv. *AP e lëshuar nga AKPT, ose Deklarata e Përputhshmërisë në heshtje;*
 - v. *Vlerësimi Strategjik Mjedisor, si dhe deklarata mjedisore në rast se është vlerësuar si e nevojshme nga Ministria përgjegjëse për mjedisin;*
 - v. *Vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak të Dokumentit të Rishikimit dhe Konfirmimi nga Prefekti.*
- e. Pas miratimit të dokumentit të rishikuar të PPV-së, nga Këshilli Kombëtar i Territorit, (Sekretariati i KKT-së), AKPT boton në RKPT vendimin e miratimit dhe dokumentin e zbardhur të PPV-së së rishikuar.
- f. Pas zbardhjes së Vendimit të KKT-së, AKPT i bën me dije në formë elektronike (e-mail) autoritetit vendor dhe Sekretariatit të KKT-së *hyrjen në fuqi të Dokumentit të Rishikimit të PPV-së.*

